Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU

# RAPORTI VJETOR I PËRMBUSHJES SË CAQEVE

## VLERËSIMI I PËRMBUSHJES SË CAQEVE TË KRU`ve TË PËRCAKTUARA NGA ARRU PËR VITIN 2016 NGA PROCESI RREGULLATOR I TARIFAVE 2015-2017

**Periudha raportuese: Janar – Dhjetor 2016**

DT/ARRU

Prishtinë, korrik 2017

## Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efiçiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

## Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik”.

# PËRMBAJTA

## KAPITULLI 1 QASJA DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

1 Parathënie ... 6
2 Sfidimi i biznes planeve rregullatore ... 7
3 Metodologjia e vlerësimit të caqeve ... 8

## KAPITULLI 2 ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE

1. Analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët ... 10
1.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në $m^3$ dhe numrit të konsumatorëve ... 11
2. Analiza e shpenzimeve operative ... 13
2. 1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura ... 14
2.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura ... 15
3. Shumat e faturimit dhe arkëtimi në vlerë monetare ... 16
3.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura ... 17
3.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura ... 18
3.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura ... 19
3.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura ... 20
4. Investimet kapitale ... 21
4.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake ... 22
4.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive ... 25
4.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët ... 26
4.4. Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët ... 29

## KAPITULLI 3 ANALIZË KRAHASUESE E KRU-ve

1. Analiza e humbjeve të ujit ... 31
2. Sasia e ujit e cila kthehet në para ... 32
3. Shpenzimet e pagave dhe të energjisë elektrike ... 33
4. Mbulimi i shpenzimeve operative dhe të investimeve kapitale vetanake nga shuma e arkëtimit ... 34

## KAPITULLI 4 RANGIMI I KRU-VE

1. Rangimi i KRU-ve sipas realizimit të caqeve ... 36
1.1 Rangimi individual sipas kriterit të përmbushjes së caqeve ... 38
1.2 Rangimi i KRU-ve sipas performances më të mirë të përmbushjes së caqeve ... 45
2. Konkluzionet e raportit ... 46

## Shtojca: Hartat e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit

## Akronimet dhe shkurtesat

| | |
|---|---|
| ARRU | Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BPRR | Biznes Plane Rregullatore |
| BRRA | Baza Rregullatore e Aseteve |
| FE | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Bifurkacioni” sh. a –Ferizaj |
| GJA | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Radoniqi” sh. a – Gjakovë |
| GJI | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” sh. a – Gjilan |
| IÇKK | Indeksi i Çmimit të Konsumit në Kosovë |
| KRU | Kompania Rajonale e Ujësjellësit |
| MIT | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica” sh. a – Mitrovicë |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| NjPMNP | Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike |
| PE | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidrodrini” sh. a – Pejë |
| PR | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Prishtina” sh. a – Prishtinë |
| PZ | Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidroregjioni-Jugor” sh. a – Prizren |
| U.N | Ujëra të ndotura |

# KAPITULLI 1

## QASJA DHE METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

# 1 PARATHËNIE

Sipas praktikave të mira të përvetësuara nga ARRU edhe kësaj radhe kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin e vitit 2016 me vlerësimin e shkallës së përmbushjes së caqeve, të procesit rregullatorë të tarifave afatmesme 2015-2017. Ky raport pasqyron të dhënat e performancës së veçantë të shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, me të cilën vlerësohet shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin rregullatorë te tarifave për vitin 2016 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Për t'u përpiluar ky raport, fillimisht janë marrë të dhënat e aprovua nga procesi tarifor 2015-2017, për vitin 2016, të cilat njëkohësisht paraqesin të dhënat bazë përmes të cilave vlerësohet afarizmi i të gjitha KRU-ve në Kosovë. Më pastaj, janë paraqitur të dhënat e realizuara nga KRU-të për të njëjtën periudhë kohore të vitit 2016 për krahasim me të dhënat e aprovuara nga ARRU. Për të pasur një pasqyrë më të qartë të zhvillimeve në sektor, në këtë raport janë paraqitur edhe të dhënat historike të cilat kanë ndodhur në vitin 2015 .

Qëllimi i këtij raporti është:

(i) Të jepet informacion për shkallën e arritjes së caqeve operative dhe financiare të KRU-ve dhe në veçanti për shkallën e investimeve kapitale të realizuara për përudhën e shikuar kohore të vitit 2016.

(i) Krahasimi i treguesve të KRU-ve me objektivat (caqet) e përcaktuara të procesit tarifor të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve t'u mundësohet KRU-ve të ndërmarrin veprime të duhura me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendet e tilla deri në përfundim të vitit 2016 nga procesi rregullatorë i tarifave 2015-2017.

Duke pasur parasysh se KRU "Mitrovica" sh. a. Mitrovicë, vepron në kushte të veçanta të operimit, pasi që ofron ujë të trajtuar me shumicë për pjesën Veriore të këtij qyteti, të dhënat e kësaj kompanie pasqyrohen për gjithë regjionin me të gjitha shërbimet që i ofron kjo kompani, duke i përfshi edhe shërbimet e furnizimit me ujë të trajtuar me shumicë të pjesës Veriore të Qytetit të tyre.

# 2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Parimi bazë i procesit rregullatorë të tarifave të periudhës tarifore 2015-2017 është krijimi i parakushteve për një qëndrueshmëri ma të mirë financiare për kompanitë, që nënkupton; kosto optimale operative për sasi dhe cilësi të caktuar shërbimi për konsumatorët e shërbyer, të cilat kemi shpresuar dhe shpresojmë se do të arrihen me tarifa të arsyeshme të cilat janë të përballueshme për t'u paguar nga të gjitha kategoritë e konsumatorëve të shërbyer, sikurse që kemi përcaktuar edhe caqe sfiduese për përmirësim të përformancës së përgjithshme të tyre, dhe atë:

1. ARRU, mendon se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.

2. Ne besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale të ujit, shumë kyçje të pa ligjshme dhe faturim jo të kënaqshëm, të cilat duhet të jenë në fokus të menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale.

3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar ngadalë, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2015-2017.

Prandaj, ARRU do të kryej monitorimin e rregullt gjatë gjithë periudhës së mbetur tarifore 2016-2017 për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator, siç po bëjmë edhe me këtë raport dhe për rishikime eventuale të politikave të ardhshme tarifore.

# 3 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË CAQEVE

Metodologjia e vlerësimit të përmbushjes së caqeve të përcaktuara me procesin tarifor 2015-2017 për vitin 2016, është uniforme për të gjitha kategoritë e të dhënave të realizuara nga KRU-të për periudhën e shikuar kohore.

Kjo metodologji do të pasqyrohet në tabela përkatëse për të gjitha kategoritë e të dhënave, sikurse në vijim:

- të dhënat historike të realizuara nga KRU gjatë vitit 2015,
- të dhënat e aprovuara nga ARRU për vitin 2016,
- të dhënat e realizuara nga KRU për vitin 2016,
- përqindja krahasuese e vitit 2016 me periudhën e njëjtë të vitit 2015,
- përqindja krahasuese e realizimit të cakut të vitit 2016, dhe
- vlerësimi përfundimtar.

Përqindja krahasuese për vitin 2016 me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2015 fitohet duke pjesëtuar të dhënat e vitit 2016 me të dhënat e vitit 2015 të periudhave të shikuara dhe të shumëzuar me 100.

Përqindja krahasuese e realizmit të cakut për vitin 2016 del si rezultat i pjesëtimit të të dhënave të aprovuara me të dhënat e realizuara dhe të shumëzuar me 100.

Vlerësimi përfundimtar për vitin 2016 i paraqitur në kolonën e fundit është vlerësim i ARRU-së, dhe identifikohet si:

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat e ujit të humbur dhe shpenzimeve operative në $m^3$.

| Kufijtë | Shkurtesa | Përshkrimi | Vlerësimi |
|---|---|---|---|
| < 98.00 % | T P | Tejkaluar pozitivisht plus | Pozitiv + |
| 98.00% - 102.00% | R | E realizuar | Pozitiv |
| 102.01%- 106.00% | P | E përafruar | Negativ |
| > 106.00% | Jo e R | Jo e Realizuar | Negativ - |
| | E pa K | E pa krahasueshme | Pa të dhëna krahasuese |

Vlerësimi i caqeve individuale për të dhënat tjera

| Kufijtë | Shkurtesa | Përshkrimi | Vlerësimi |
|---|---|---|---|
| > 102.00 % | T P | Tejkaluar pozitivisht plus | Pozitiv + |
| 98.01% – 102.00% | R | E realizuar | Pozitiv |
| 94.00% – 98.00% | P | E përafruar | Negativ |
| <94.00% | Jo e R | Jo e Realizuar | Negativ - |
| | E pa K | E pa krahasueshme | Pa të dhëna krahasuese |

# KAPITULLI 2

## ANALIZA E PËRMBUSHJES SË CAQEVE

# 1. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve prej nga është bërë krahasimi i të dhënave të realizuara me ato historike si dhe të dhënave të realizuara me të dhënat e aprovuara, me të cilat njëherit bëhet edhe vlerësimi i përmbushjes së caqeve.

*Tabela Nr. 1. Krahasimi i të dhënave të aprovuara për vitin 2016 me të dhënat e realizuara për vitin 2016 dhe të dhënat historike për periudhën e njëjtë të vitit 2015.*

| Emri i KRU | Të dhënat operative | Njësia | Historike 2015 | Aprovuara 2016 | Realizuara nga KRU-të 2016 | % krahasuese 2015/2016 | % real cak 2016 | Vlerësimi për 2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PR | Uji i prodhuar | $m^3$ | 41,282,430 | 44,433,884 | 44,846,198 | 108.63% | 100.93 | R |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 20,899,398 | 19,393,388 | 23,630,379 | 113.07% | 121.85 | Jo e R |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 20,383,032 | 25,040,496 | 21,215,819 | 104.09% | 84.73 | Jo e R |
| | Konsumatorët | Nr | 113,848 | 110,785 | 122,403 | 107.51% | 110.49 | T P |
| PZ | Uji i prodhuar | $m^3$ | 17,308,689 | 21,133,253 | 17,371,213 | 100.36% | 82.20 | Jo e R |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 10,010,227 | 11,680,422 | 10,025,665 | 100.15% | 85.83 | T P |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 7,298,462 | 9,452,831 | 7,345,548 | 100.65% | 77.71 | Jo e R |
| | Konsumatorët | Nr | 42,761 | 45,639 | 44,633 | 104.38% | 97.80 | P |
| PE | Uji i prodhuar | $m^3$ | 25,559,988 | 24,722,000 | 25,563,726 | 100.01% | 103.40 | T P |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 16,776,858 | 14,722,250 | 16,556,768 | 98.69% | 112.46 | Jo e R |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 8,783,130 | 9,999,750 | 9,006,958 | 102.55% | 90.07 | Jo e R |
| | Konsumatorët | Nr | 43,199 | 40,862 | 45,207 | 104.65% | 110.63 | T P |
| MIT | Uji i prodhuar | $m^3$ | 23,154,548 | 22,874,000 | 25,199,252 | 108.83% | 110.17 | T P |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 13,884,319 | 11,501,113 | 15,703,746 | 113.10% | 136.54 | Jo e R |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 9,270,229 | 11,372,887 | 9,495,506 | 102.43% | 83.49 | Jo e R |
| | Faturimi-Jug | $m^3$ | 4,562,790 | 6,693,387 | 5,052,184 | 110.73% | 75.48 | Jo e R |
| | Faturimi-Veri | $m^3$ | 4,707,439 | 4,679,500 | 4,443,322 | 94.39% | 94.95 | P |
| | Konsumatorët | Nr | 26,192 | 26,108 | 27,403 | 104.62% | 104.96 | T P |
| GJA | Uji i prodhuar | $m^3$ | 13,721,967 | 14,466,772 | 15,247,974 | 111.12% | 105.40 | T P |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 6,642,820 | 6,949,548 | 7,230,107 | 108.84% | 104.04 | P |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 7,079,147 | 7,517,224 | 8,017,867 | 113.26% | 106.66 | T P |
| | Konsumatorët | Nr | 32,935 | 30,491 | 34,353 | 104.31% | 112.67 | T P |
| FE | Uji i prodhuar | $m^3$ | 7,481,265 | 7,640,917 | 7,275,462 | 97.25% | 95.22 | P |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 3,905,572 | 3,526,217 | 3,816,466 | 97.72% | 108.23 | Jo e R |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 3,575,693 | 4,114,700 | 3,458,996 | 96.74% | 84.06 | Jo e R |
| | Konsumatorët | Nr | 23,540 | 23,746 | 25,285 | 107.41% | 106.48 | T P |
| GJI | Uji i prodhuar | $m^3$ | 8,535,394 | 7,713,960 | 8,232,750 | 96.45% | 106.73 | T P |
| | Uji i humbur | $m^3$ | 5,181,472 | 3,737,000 | 4,699,450 | 90.70% | 125.75 | Jo e R |
| | Uji i faturuar | $m^3$ | 3,353,922 | 3,976,960 | 3,533,300 | 105.35% | 88.84 | Jo e R |
| | Konsumatorët | Nr | 23,575 | 23,691 | 28,001 | 118.77% | 118.19 | T P |
| SEKTORI | **Uji i prodhuar** | **$m^3$** | 137,044,281 | 142,984,787 | 143,736,575 | 104.88% | 100.53 | R |
| | **Uji i humbur** | **$m^3$** | 77,300,666 | 71,509,938 | 81,662,581 | 105.64% | 114.20 | Jo e R |
| | **Uji i faturuar** | **$m^3$** | 59,743,615 | 71,474,848 | 62,073,994 | 103.90% | 86.85 | Jo e R |
| | **Konsumatorët** | **Nr** | 306,050 | 301,320 | 327,285 | 106.94% | 108.62 | T P |

## 1.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, ujit të humbur, ujit të faturuar në $m^3$ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1. janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin vizual të të dhënave historike për vitin 2015 me të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe të dhënat e realizuara nga KRU-të për vitin 2016.









## Konsumatorët




Nga tabela numër 1 vërejmë se në baza sektoriale në dy nga katër treguesit e paraqitur KRU janë mirë krahasuar me të dhënat e provuara edhe atë te sasia e ujit të prodhuar, ku prodhimi në total i është tejkaluar sasia e prodhimit të aprovuar nga ARRU dhe te numri i konsumatorëve, ku numri i konsumatorëve në total tejkalon numrin e aprovuar nga ARRU. Të dhënat për ujin e faturuar dhe humbjet e ujit në nivel të sektorit nuk kanë arritur të realizojnë pritjet të cilat janë aprovuar nga rregullatori. Për tu dalluar vlen të përmendet KRU Radoniqi e cila ka arritur të realizoj respektivisht përafroj të dhënat e realizuara me ato të aprovuarpër të gjithë treguesit e paraqitur.

# 2. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor 2015-2017, ARRU ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me shpenzimet e tyre të drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulen deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pasur shpenzime operative mbi kostot optimale mesatare të disa kompanive të vlerësuara si shpenzime të arsyeshme dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative të KRU-ve të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative të paraqitura në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim-shpërndarje, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të ndotura, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të ndotura
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, i cili gjendet i publikuar në ueb faqen zyrtare të ARRU (www.arru-rks.org).

## 2. 1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të ndotura për secilën KRU dhe sektorin, duke i paraqitur edhe shpenzimet operative historike për vitin 2015, ato të aprovuara nga ARRU si dhe ato të realizuara nga KRU gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2016, të cilat janë vlerësuar me shkallën e përmbushjes së caqeve në % dhe me vlerësimin tonë përfundimtar për këtë periudhë kohore.

*Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura në €*

| Emri i KRU | Zërat e shpenzimeve operative | Valuta | Historike 2015 | Aprovuara nga ARRU 2016 | Realizuara nga KRU 2016 | % Krahasuese viteve 2015/2016 | % e realizmit të cakut 2016 | Vlerësimi përfundimtar për 2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PR | Ujë | € | 8,830,840 | 7,463,017 | 8,570,268 | 97.05% | 114.84% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 165,972 | 547,823 | 150,658 | 90.77% | 27.50% | T P |
| | **Totali** | **€** | **8,996,812** | **8,010,840** | **8,720,926** | **96.93%** | **108.86%** | Jo e R |
| PZ | Ujë | € | 2,831,779 | 3,067,695 | 2,850,253 | 100.65% | 92.91% | T P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 413,440 | 213,460 | 418,385 | 101.20% | 196.00% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **3,245,219** | **3,281,155** | **3,268,638** | **100.72%** | **99.62%** | R |
| PE | Ujë | € | 2,073,805 | 2,032,641 | 2,189,131 | 105.56% | 107.70% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 130,021 | 134,456 | 110,121 | 84.69% | 81.90% | T P |
| | **Totali** | **€** | **2,203,826** | **2,167,096** | **2,299,252** | **104.33%** | **106.10%** | Jo e R |
| MIT | Ujë | € | 2,115,556 | 2,105,301 | 2,260,479 | 106.85% | 107.37% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 342,366 | 232,036 | 187,426 | 54.74% | 80.77% | T P |
| | **Totali** | **€** | **2,457,922** | **2,337,337** | **2,447,905** | **99.59%** | **104.73%** | P |
| GJA | Ujë | € | 2,391,361 | 2,148,572 | 2,661,227 | 111.29% | 123.86% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 187,978 | 260,180 | 185,443 | 98.65% | 71.27% | T P |
| | **Totali** | **€** | **2,579,339** | **2,408,752** | **2,846,670** | **110.36%** | **118.18%** | Jo e R |
| FE | Ujë | € | 1,331,980 | 1,096,876 | 1,344,305 | 100.93% | 122.56% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 112,056 | 191,422 | 227,501 | 203.02% | 118.85% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **1,444,036** | **1,288,298** | **1,571,806** | **108.85%** | **122.01%** | Jo e R |
| GJI | Ujë | € | 1,333,395 | 1,137,415 | 1,388,472 | 104.13% | 122.07% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 133,435 | 106,039 | 140,108 | 105.00% | 132.13% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **1,466,830** | **1,243,454** | **1,528,580** | **104.21%** | **122.93%** | Jo e R |
| Sektori | **Ujë** | **€** | **20,908,716** | **19,051,517** | **21,264,135** | **101.70%** | **111.61%** | Jo e R |
| | **Ujëra të Ndotura** | € | **1,485,268** | **1,685,415** | **1,419,642** | **95.58%** | **84.23%** | T P |
| **Totali i përgjithshëm** | | € | **22,393,984** | **20,736,932** | **22,683,777** | **101.29%** | **109.39%** | Jo e R |

Nga totali i shpenzimeve operative që kanë ndodhur për vitin 2016, 93.74% të shpenzimeve kanë ndodhur në shërbimin e ujit, ndërsa 6.26% janë shpenzime të ujërave të ndotura. Totali i shumës së shpenzimeve operative të realizuara për të dy shërbimet nga KRU-të për vitin 2016 është 22,683,777 €, të cilat si të tilla janë përtej kufijve që ka përcaktuar ARRU, në masën prej 9.39%.



## 2.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të ndotura









# 3. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, për krahasim më të lehtë të rezultateve të arritura nga secila kompani në veçanti dhe sektorit në përgjithësi, në të cilat hynë të dhënat historike të realizuara për vitin 2015, pastaj të dhënat e aprovuara nga ARRU dhe ato të realizuara nga KRU-të gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2016, sipas procesit rregullatorë të përcaktimit të tarifave të viteve 2015-2017.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten të dhënat e aprovuara për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar për vitin 2016 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e realizuara gjatë të njëjtës periudhë të këtij viti me të dhënat historike për periudhën e njëjtë kohore të vitit 2015.

Sipas politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ARRU në Mars të vitit 2014, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetrike për ujë i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim atribuohet si e vetme për shërbimin e ujërave të ndotura.

Duke pasur parasysh se jo të gjitha KRU-të kanë qenë në gjendje të bëjnë ndarjen e arkëtimit për ujë dhe ato për ujëra të ndotura, ARRU ka qenë e detyruar që të bëjë këtë ndarje sipas një gjykimi i cili është konsideruar si më i arsyeshmi, për kushtet në të cilat gjendemi. Kjo ndarje është bazuar në faturimin e planifikuar sipas BPRR të aprovuar nga ARRU-KRU dhe ato të realizuara nga KRU-të dhe sektorit të cilit i takojnë.

*Shënim:*
*Duhet theksuar se për KRU "Mitrovica" sh. a – Mitrovicë, Qeveria e Republikës së Kosovës ndan mjete nga Buxheti i Republikës së Kosovës çdo vit (subvencione), që nga pas lufta, për të mbuluar një shumë të caktuar të shpenzimeve operative të cilat krijohen me rastin e furnizimit me ujë të pjesës Veriore të Qytetit të Mitrovicës. Në mënyrë që vlerësimi i ARRU-ës të jetë real, të dhënat e më poshtme i atribuohen të dy zonave të shërbimit (Jugore dhe Veriore), dhe si të tilla do të identifikohen aty ku është e mundur (faturimi e arkëtimi) për periudhat e shikuara.*

## 3.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi i shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare, për të dhënat historike për vitin 2015, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të dhe sektori për vitin 2016.

*Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të faturimit për ujë dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare*

| Emri i KRU | Të dhënat e faturimit | Valuta | Historike 2015 | Aprovuara nga ARRU 2016 | Realizuara nga KRU 2016 | % Krahas. 2015/2016 | % e real. të cakut 2016 | Vlerësi mi përfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PR | Ujë | € | 11,587,912 | 13,402,955 | 12,233,098 | 105.57% | 91.27% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 1,137,772 | 1,307,229 | 1,197,198 | 105.22% | 91.58% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **12,725,684** | **14,710,184** | **13,430,296** | **105.54%** | **91.30%** | **Jo e R** |
| PZ | Ujë | € | 3,651,899 | 4,467,285 | 3,694,851 | 101.18% | 82.71% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 439,721 | 507,083 | 444,577 | 101.10% | 87.67% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **4,091,620** | **4,974,368** | **4,139,428** | **101.17%** | **83.22%** | **Jo e R** |
| PE | Ujë | € | 3,130,347 | 3,321,926 | 3,210,058 | 102.55% | 96.63% | P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 312,148 | 325,823 | 326,671 | 104.65% | 100.26% | R |
| | **Totali** | **€** | **3,442,495** | **3,647,749** | **3,536,729** | **102.74%** | **96.96%** | **P** |
| MIT | Ujë-Jugu | € | 2,169,386 | 2,982,876 | 2,363,948 | 108.97% | 79.25% | Jo e R |
| | Ujë-Veriu | € | 800,409 | 795,647 | 755,509 | 94.39% | 94.96% | P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 439,409 | 536,868 | 457,780 | 104.18% | 85.27% | Jo e R |
| | **Totali**[1] | **€** | **2,608,795** | **3,519,744** | **2,821,728** | **108.16%** | **80.17%** | **Jo e R** |
| GJA | Ujë | € | 3,238,990 | 3,386,495 | 3,278,239 | 101.21% | 96.80% | P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 512,941 | 452,514 | 513,184 | 100.05% | 113.41% | T P |
| | **Totali** | **€** | **3,751,931** | **3,839,009** | **3,791,423** | **101.05%** | **98.76%** | **R** |
| FE | Ujë | € | 1,735,876 | 1,805,393 | 1,610,129 | 92.76% | 89.18% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 457,461 | 538,569 | 445,022 | 97.28% | 82.63% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **2,193,337** | **2,343,962** | **2,055,151** | **93.70%** | **87.68%** | **Jo e R** |
| GJI | Ujë | € | 1,571,227 | 1,753,608 | 1,634,056 | 104.00% | 93.18% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 282,510 | 265,262 | 304,446 | 107.76% | 114.77% | T P |
| | **Totali** | **€** | **1,853,737** | **2,018,869** | **1,938,502** | **104.57%** | **96.02%** | **P** |
| Sektori | Ujë | € | 27,886,046 | 31,916,185 | 28,779,888 | 103.21% | 90.17% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 3,581,962 | 3,933,348 | 3,688,878 | 102.98% | 93.78% | Jo e R |
| Totali i përgjithshëm | | € | **31,468,008** | **35,849,533** | **32,468,766** | **103.18%** | **90.57%** | **Jo e R** |

Është e rëndësishme të theksohet se në sektorin e ujit në Kosovë për këtë periudhë kohore, 88.64% të shumës së faturimit në vlerë financiare realizohet nga shërbimi i ujit, ndërsa 11.36% rrjedh nga shërbimi i ujërave të ndotura. Në total për sektorin, për vitin 2016 është realizuar faturimi në vlerë prej 32,468,766 €, e që paraqet 90.57% të shumës së aprovuar nga procesi rregullator për këtë periudhë kohore.




[1] Në këtë pikë, totali nuk përmban edhe sasinë e faturimit për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Por, për të qenë të informuar palët e interesit për sasinë e ujit të faturara për atë pjesë, ne e kemi vendosur vetëm si shifër ilustrative.

## 3.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të ndotura









## 3.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare, për të dhënat historike për vitin 2015, ato të aprovuara nga ARRU dhe të realizuara nga KRU-të për vitin 2016.

*Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura në vlerë monetare*

| Emri i KRU | Arkëtimi për shërbimet përkatëse | Njësia monetare | Historike 2015 | Aprovuara nga ARRU 2016 | Realizuara nga KRU 2016 | % krahasuese 2016/2015 | % e real. të cakut 2016 | Vlerësimi përfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| PR | Ujë | € | 8,750,405 | 10,736,265 | 11,300,597 | 129.14% | 105.26% | T P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 859,168 | 1,058,005 | 1,105,938 | 128.72% | 104.53% | T P |
| | **Totali** | **€** | **9,609,573** | **11,794,271** | **12,406,535** | 129.11% | 105.19% | T P |
| PZ | Ujë | € | 2,710,273 | 3,562,446 | 3,225,006 | 118.99% | 90.53% | Jo e R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 326,341 | 409,355 | 388,044 | 118.91% | 94.79% | P |
| | **Totali** | **€** | **3,036,614** | **3,971,801** | **3,613,050** | 118.98% | 90.97% | Jo e R |
| PE | Ujë | € | 2,277,244 | 2,560,254 | 2,511,308 | 110.28% | 98.09% | R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 227,079 | 260,959 | 255,563 | 112.54% | 97.93% | P |
| | **Totali** | **€** | **2,504,323** | **2,821,213** | **2,766,871** | 110.48% | 98.07% | R |
| MIT | Ujë | € | 1,210,454 | 1,973,174 | 1,384,487 | 114.38% | 70.17% | Jo e R |
| | Subvencionet | € | 347,400 | 494,521 | 816,849 | 235.13% | 165.18% | T P |
| | Ujërat e ndotura | € | 245,177 | 375,438 | 268,107 | 109.35% | 71.41% | Jo e R |
| | **Totali**[2] | **€** | **1,455,631** | **2,348,612** | **1,652,594** | 113.53% | 70.36% | Jo e R |
| GJA | Ujë | € | 2,706,922 | 2,638,131 | 3,100,979 | 114.56% | 117.54% | T P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 428,680 | 357,767 | 485,435 | 113.24% | 135.68% | T P |
| | **Totali** | **€** | **3,135,602** | **2,995,899** | **3,586,414** | 114.38% | 119.71% | T P |
| FE | Ujë | € | 1,136,633 | 1,306,004 | 1,313,256 | 115.54% | 100.56% | R |
| | Ujëra të Ndotura | € | 299,540 | 393,513 | 362,969 | 121.18% | 92.24% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **1,436,173** | **1,699,517** | **1,676,225** | 116.71% | 98.63% | R |
| GJI | Ujë | € | 1,231,198 | 1,379,801 | 1,334,767 | 108.41% | 96.74% | P |
| | Ujëra të Ndotura | € | 221,372 | 210,174 | 248,684 | 112.34% | 118.32% | T P |
| | **Totali** | **€** | **1,452,570** | **1,589,975** | **1,583,451** | 109.01% | 99.59% | R |
| Sektori | Ujë | € | **20,023,127** | **24,156,075** | **24,170,399** | 120.71% | 100.06% | R |
| | Ujëra të Ndotura | € | **2,607,359** | **3,065,212** | **3,114,741** | 119.46% | 101.62% | R |
| **Totali i përgjithshëm** | | **€** | **22,630,486** | **27,221,287** | **27,285,140** | 120.57% | 100.23% | R |

Për sektorin e ujit në Kosovë, sipas vlerësimeve të ARRU-së për vitin 2016, 88.58% e arkëtimit rrjedh nga shërbimi i ujit, ndërsa pjesa tjetër prej 11.42% rrjedh nga shërbimi i ujërave të ndotura. Në total, gjatë vitit 2016 është realizuar arkëtimi në vlerë prej 27,285,140€, e që paraqet përmbushjen e cakut prej 100.23 % të shumës së aprovuar për vitin 2016.




[2] Subvencionet e dhëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për të mbuluar kostot e ujit të trajtuar me shumicë për pjesën veriore të Qytetit të Mitrovicës, nuk përbëjnë totalin në këtë pikë, por ato janë vendosur vetëm si shifër ilustrative për të informuar palët e interesit.

### 3.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të ndotura










Siç edhe vërehet nga diagrami, të vetmet KRU të cilat i kanë realizuar dhe tejkaluar cakun e arkëtimit janë KRU "Radoniqi" Gjakovë dhe KRU "Prishtina" për çka meritojnë të komplimentohen.

# 4. INVESTIMET KAPITALE

Me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2015-2017, ARRU-KRU kanë planifikuar realizimin e shumave të caktuara të investimeve, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit** dhe **shërbimet e kanalizimit,** të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit,
- Investime në distribuim, dhe
- Investime në aktivitete biznisore.

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të ndotura janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin ujërave të ndotura,
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit, dhe
- Investime në aktivitete biznisore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asete të infrastrukturës** dhe **ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** më tutje janë të ndara në investime: *(i)* të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës, *(ii)* dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha investimet në asetet mbitokësore siç janë: *(i)* fabrikat për trajtimin e ujit, *(ii)* ndërtesat administrative, *(iii)* mjetet transportuese, *(iv)* pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në ueb faqen zyrtare të ARRU.

## 4.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit për vitin 2016. Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ARRU me ato të realizuara nga KRU-të për vitin 2016, % e realizimit të investimeve të planifikuara dhe vlerësimin tonë përfundimtar.

*Tabela Nr. 5. Shumat e investimeve kapitale për ujë te financuar nga burimet vetanake të KRU sipas kategorive të theksuara ma lartë për vitin 2016 shprehur në €*

| Emri i KRU | Kategori të Investimeve | Aprovuara 2015 | Realizuara 2016 | % e real. të cakut 2016 | Vlerësimi përfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|
| **PR** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 3,380,853 | 2,558,439[3] | 75.67% | Jo e R |
| | Distribuim | 763,659 | 428,731 | 56.14% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 1,019,294 | 92,903 | 9.11% | Jo e R |
| | **Totali** | **5,163,806** | **3,080,073** | **59.65%** | **Jo e R** |
| **PZ** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 122,704 | 89,331 | 72.80% | Jo e R |
| | Distribuim | 194,531 | 12,459 | 6.40% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 15,880 | 18,729 | 117.94% | T P |
| | **Totali** | **333,115** | **120,519** | **36.18%** | **Jo e R** |
| **PE** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 14,964 | 7,115 | 47.55% | Jo e R |
| | Distribuim | 383,576 | 124,816 | 32.54% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 39,904 | 19,426 | 48.68% | Jo e R |
| | **Totali** | **438,444** | **151,357** | **34.52%** | **Jo e R** |
| **MIT** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Distribuim | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitetet biznesore | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **0** | **0** | **!** | **E pa K** |
| **GJA** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 299,279 | 12,221 | 4.08% | Jo e R |
| | Distribuim | 109,736 | 129,314 | 117.84% | T P |
| | Aktivitetet biznesore | 64,345 | 329,864 | 512.65% | T P |
| | **Totali** | **473,359** | **471,399** | **99.59%** | **R** |
| **FE** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 134,675 | 17,390 | 12.91% | Jo e R |
| | Distribuim | 132,680 | 6,256 | 4.72% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 4,988 | 682 | 13.67% | Jo e R |
| | **Totali** | **272,344** | **24,328** | **8.93%** | **Jo e R** |
| **GJI** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 19,952 | 9,008 | 45.15% | Jo e R |
| | Distribuim | 4,988 | 32,262 | 646.79% | T P |
| | Aktivitetet biznesore | 0 | 27,397 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **24,940** | **68,667** | **275.33%** | **T P** |
| **Sektori** | Resurse dhe trajtimi i ujit | 3,972,428 | 2,693,504 | 67.80% | Jo e R |
| | Distribuim | 1,589,170 | 733,838 | 46.18% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 1,144,410 | 489,001 | 42.73% | Jo e R |
| | **Totali** | **6,706,008** | **3,916,343** | **58.40%** | **Jo e R** |

[3] Te shumat e paraqitura të investimeve në resurse dhe trajtim janë përfshirë edhe shuma e kthimit të kredisë për fabrikën e ujit në Shkabaj për vitin 2016 edhe te të dhënat e aprovuara edhe te të dhënat e realizuara.

*Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale për ujëra të ndotura te financuar nga burimet vetanake të kompanive sipas kategorive të theksuara ma lartë për vitin 2016 shprehur në €*

| Emri i KRU | Kategori të Investimeve | Aprovuara 2016 | Realizuara 2016 | % e real. të cakut 2016 | Vlerësimi përfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|
| **PR** | Grumbullimi i u.n | 282,070 | 133,636 | 47.38% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 0 | 2,873 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **282,070** | **136,509** | **48.40%** | **Jo e R** |
| **PZ** | Grumbullimi i u.n | 110,733 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 0 | 2,749 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **110,733** | **2,749** | **2.48%** | **Jo e R** |
| **PE** | Grumbullimi i u.n | 104,748 | 87,349 | 83.39% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 144,651 | 1,580 | 1.09% | Jo e R |
| | **Totali** | **249,399** | **88,929** | **35.66%** | **Jo e R** |
| **MIT** | Grumbullimi i u.n | 74,820 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **74,820** | **0** | **0.00%** | **Jo e R** |
| **GJA** | Grumbullimi i u.n | 24,940 | 19,279 | 77.30% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 0 | 2,094 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **24,940** | **21,373** | **85.70%** | **Jo e R** |
| **FE** | Grumbullimi i u.n | 298,531 | 150 | 0.05% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 0 | 170 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **298,531** | **320** | **0.11%** | **Jo e R** |
| **GJI** | Grumbullimi i u.n | 42,897 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 0 | 2,062 | ! | E pa K |
| | **Totali** | **42,897** | **2,062** | **4.81%** | **Jo e R** |
| **SEKTOR I** | Grumbullimi i u.n | 938,738 | 240,414 | 25.61% | Jo e R |
| | Trajtim i u.n | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Trajtimi i llumit | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Aktivitete biznesore | 144,651 | 11,528 | 7.97% | Jo e R |
| | **Totali** | **1,083,389** | **251,942** | **23.25%** | **Jo e R** |

*Tabela Nr. 7. Shumat e Investimeve kapitale të financuara nga burimet vetanke të kompanive për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për vitin 2016.*

| Emri i KRU | Investimet në shërbimet përkatëse | Njësia | Historike 2015 | Aprovuara 2016 | Realizuar 2016 | % Krahasuese 2015/ 2016 | % e real. të cakut 2016 | Vlerësimi përfundimtar për 2016 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PR** | Ujë | € | 709,559 | 5,163,806 | 3,080,073 | 434.08% | 59.65% | Jo e R |
| | Ujëra të ndotura | € | 19,062 | 282,070 | 136,509 | 716.13% | 48.40% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **728,621** | **5,445,876** | **3,216,582** | **441.46%** | **59.06%** | **Jo e R** |
| **PZ** | Ujë | € | 131,416 | 333,115 | 120,519 | 91.71% | 36.18% | Jo e R |
| | Ujëra të ndotura | € | 1,085 | 110,733 | 2,749 | 253.36% | 2.48% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **132,501** | **443,848** | **123,268** | **93.03%** | **27.77%** | **Jo e R** |
| **PE** | Ujë | € | 229,588 | 438,444 | 151,357 | 65.93% | 34.52% | Jo e R |
| | Ujëra të ndotura | € | 18,403 | 249,399 | 88,929 | 483.23% | 35.66% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **247,991** | **687,843** | **240,286** | **96.89%** | **34.93%** | **Jo e R** |
| **MIT** | Ujë | € | 0 | 0 | 0 | ! | ! | E pa K |
| | Ujëra të ndotura | € | 0 | 74,820 | 0 | ! | ! | E pa K |
| | **Totali** | **€** | **0** | **74,820** | **0** | **!** | **!** | **E pa K** |
| **GJA** | Ujë | € | 651,424 | 473,359 | 471,399 | 72.36% | 99.59% | R |
| | Ujëra të ndotura | € | 13,532 | 24,940 | 21,373 | 157.94% | 85.70% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **664,956** | **498,299** | **492,772** | **74.11%** | **98.89%** | **R** |
| **FE** | Ujë | € | 105,396 | 272,344 | 24,328 | 23.08% | 8.93% | Jo e R |
| | Ujëra të ndotura | € | 12,504 | 298,531 | 320 | 2.56% | 0.11% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **117,900** | **570,874** | **24,648** | **20.91%** | **4.32%** | **Jo e R** |
| **GJI** | Ujë | € | 33,322 | 24,940 | 68,667 | 206.07% | 275.33 | T P |
| | Ujëra të ndotura | € | 782 | 42,897 | 2,062 | 263.68% | 4.81% | Jo e R |
| | **Totali** | **€** | **34,104** | **67,837** | **70,729** | **207.39%** | **104.26** | **T P** |
| **SEKTORI** | Ujë | € | **1,860,705** | **6,706,008** | **3,916,343** | **210.48%** | **58.40%** | **Jo e R** |
| | Ujëra të ndotura | € | **65,368** | **1,083,389** | **251,942** | **385.42%** | **23.25%** | **Jo e R** |
| **Totali i përgjithshëm** | | **€** | **1,926,073** | **7,789,397** | **4,168,285** | **216.41%** | **53.51%** | **Jo e R** |

Ndryshimi i madh i të dhënave për vitin 2016 në krahasim me vitin 2015 të KRU Prishtina, për të dhënat e realizuara dhe për të dhënat e aprovuara, është si pasojë e ndikimit të investimeve kapitale në fabrikën për përpunimin e ujit në Shkabaj. Fillimisht për të dhënat e aprovuara ARRU ka lejuar shumën e kthimit të kredisë si investim dhe të dhënat e realizuara kanë përfshirë në vete edhe pagesat në emër të kthimit të kredisë investuese për FPU gjatë periudhës raportuese.

[4] Te shumat e paraqitura të investimeve për ujë janë përfshirë edhe shuma e kthimit të kredisë për fabrikën e ujit në Shkabaj për vitin 2016 edhe te të dhënat e aprovuara edhe te të dhënat e realizuara.

## 4.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake të kompanive









## 4.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit për vitin 2016. Krahasimi i këtyre të dhënave pasqyron shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë.

*Tabela Nr. 8. Shumat e investimeve kapitale për ujë të financuar nga donatorët sipas kategorive të theksuara më lartë për vitin 2016 shprehur në €.*

| Emri i KRU | Kategori të Investimeve | Aprovuara 2015 | Realizuara 2016 | % e real. të cakut 2016 | Vlerësimi përfundimtar |
|---|---|---|---|---|---|
| PR | Resurse dhe trajtimi i | 4,987,981 | 78,906 | 1.58% | Jo e R |
| | Distribuim | 4,073,517 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | **Totali** | 9,061,498 | **78,906** | 0.87% | Jo e R |
| PZ | Resurse dhe trajtimi i | 14,639,724 | 104,208 | 0.71% | Jo e R |
| | Distribuim | 2,166,779 | 940,841 | 43.42% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 19,952 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | **Totali** | 16,826,454 | 1,045,049 | 6.21% | Jo e R |
| PE | Resurse dhe trajtimi i | 0 | 0 | ! | E pa K |
| | Distribuim | 5,487 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 4,988 | 0 | 0.00% | Jo e R |
| | **Totali** | 10,475 | **0** | 0.00% | Jo e R |
| MIT | Resurse dhe trajtimi i | 0 | 8,145,969 | ! | E pa K |
| | Distribuim | 3,629,754 | 104,739 | 2.89% | Jo e R |
| | Aktivitetet biznesore | 255,685 | 3,827 | 1.50% | Jo e R |
| | **Totali** | 3,885,438 | **8,254,535** | 212.45% | T P |
| GJA | Resurse dhe trajtimi i | 1,396,635 | 1,422,775 | 101.87% | R |
| | Distribuim | 0 | 18,306 | ! | E pa K |
